



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.74/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

#### **V E N D I M**

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.74/2025 e datës 20.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 20.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon me date 19.01.2025, kanë vërejtur se ne Sheshin "Nene Terezë" në Prishtinë është vendosur një shtëpize nga Subjekti Politik LVV, me mbishkrimin "Behu Vullnetar", i cili veprim është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, nen paragrafi 1.2 te LZP, i cili shprehimisht thotë: *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Më tej në ankesë thuhet se pavarësisht, nëse e njëjta mund të ketë leje nga komuna për vendosje apo jo, ajo nuk është arsyetim për mos dënim ngase për rastin identik ne vitin 2021 ne zgjedhjet lokale, LDK ishte dënuar nga PZAP-i (meqë Vendimi në arkivin elektronike te PZAP ishte i pamundur te gjendet, sigurisht Paneli mund ta siguroj nga arkiva fizike, vendim qe ka qene i nxjerr gjate muajit shtator 2021).

Andaj, duke u bazuar ne gjithë këto kërkojmë nga ana juaj si organ kompetent dhe i autorizuar qe te shqiptoni mase sanksionuese ndaj subjektit politik LVV.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e shtëpizë në kundërshtim me rregullativën zgjedhore.

Më datë 21.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 22.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LVV thekson se i kundërshtojnë pretendimet në ankesë në tërësi, sepse sipas tyre në shtëpizën e vendosur në sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë, me qëllim rekrutimin e pjesëtarëve për aktivitetin "Bëhu Vullnetar", konsiderojnë se këto veprime janë në pajtim me legjislacionin në fuqi i cili rregullon mënyrën se si subjektet politike duhet të veprojnë, për arsye se për aktivitetin në fjalë, vullnetarët janë pajisur me leje përkatëse nga organi kompetent për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, duke konsideruar se vendimi i Komunës së Prishtinës, i përket të drejtës publike dhe nëse pretendohet se i njëjti nuk është i ligjshëm, atëherë duhet të ndjekjet procedura e kontestimit të vendimit dhe jo të kërkohet llogari për vendimet e organeve shtetërore nga subjektet politike, e aq më pak duke akuzuar për Shkelje të ligjit, për të cilën edhe po që se de facto ka ndodhur, ne si subjekt lidhemi me lejen e lëshuar, pasi e njëjta prezumohet e rregullt deri sa të ketë një vendim i cili e konsideron të jashtëligjshëm.

Më tej në përgjigje thuhet se sa i përket përmbajtjes së vendosur në shtëpizë, vërejmë sloganin "Bëhu Vullnetar" e Cila në vetvete përbën ftesë për punë dhe jo fushatë të palejuar ashtu siç propagandon LDK në këtë ankesë, bazuar në Ligjin e Punës edhe pse një punë e tillë bëhet në bazë vullnetarë (ashtu sic është e gravuar në shtand thirrja "Bëhu Vullnetar") ky ligj njih një punë të tillë pa kompensim dhe nuk do të thotë se subjekti politik

Sipas tyre LVV, aktivitetin e saj e shtrinë vetëm në kohë fushate, mirëpo për qytetarët kjo shtëpizë është një mundësi punësimi jo fushatë zgjedhore, pasi në të nuk ka asnjë numër të partisë VETËVENDOSJE e as ndonjë kandidatit të saj për zgjedhjet e 9 shkurtit dhe se jo çdo aktivitet i Lëvizjes VETËVENDOSJE! do te duhet të konsiderohet fushatë, çka vërtetohet edhe nga provat e bashkangjitura nga vetë ankuesi.

Për më tepër, një veprim të tillë e arsyeton edhe Rregullorja Zgjedhore, konkretisht neni 5 par 1 nën par 1.2 i cili shprehimisht thotë të publikojnë dhe te shpërndaje afishe përmes standeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore dhe se këtë veprim ligji nuk e sanksionon por vetëm si kusht kërkon lejen nga një organ kompetent, atëherë vullnetarët edhe po që se kanë shpërndarë përmbajtje zgjedhore, konsiderojmë se janë në pajtim me rregulloren dhe ligjin në fuqi, mirëpo ankuesi ka dështuar të vërtetojë me prova konkrete se është bërë fushatë në shtandin,

Ndërsa sa i përket pretendimeve se për një rast në të kaluarën PZAP-i, ka gjetur shkelje, këtë vendim Lëvizja VETËVENDOSJE! e konsideron si të ndryshëm nga ky që shtjellohet pasi që LDK ka qenë e përfshirë në fushatë me rastin e shkeljeve të gjetura nga PZAP dhe gjithashtu referimin në praktika e konsideron si burim sekondar të së drejtës, duke qenë se normat janë konkrete dhe përmbajnë burim primar të së drejtës në sistemin tonë pozitiv kontinental, duke legjitimuar veprimet e "Vullnetarëve" kur të njëjtit kanë zhvilluar aktivitetin lidhur nate rekrutimin e vullnetarëve.

Si provë në përgjigje kanë bashkangjitur Pëlqimin për vendosjen e shtëpizës dhe fotografi të shtëpizës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Pëlqimin e leshur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë”, për vendosjen e shtëpizës me mbishkrimin "Behu Vullnetar", vërtetoi se shtëpiza e vendosur nga Subjekti Politik LVV, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, neni 5 Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.74/2025 datë 22.01.2025

Kryesues i Panelit  
Kujtim Pasulli

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.